



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/17

Datë: 05.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M


Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25.02.2022, për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare "me qëllim të linjzimit të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP) të Bashkimit Evropian"

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25.02.2022, plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2025/2572, të datës 15 dhjetor 2025, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/2643 për masa kufizuese në lidhje me aktivitetet destabilizuese të Rusisë;
 - 1.2. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2025/2561, të datës 15 dhjetor 2025, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2022/2319 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Haiti;
 - 1.3. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2025/2580, të datës 15 dhjetor 2025, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2016/849 për masa kufizuese kundër Republikës Popullore Demokratike të Koresë;
 - 1.4. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2025/1497, të datës 18 korrik 2025, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2017/1775 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Mali;
 - 1.5. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2025/2586, të datës 15 dhjetor 2025, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2017/2074 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Venezuelë;
 - 1.6. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2025/2585, të datës 15 dhjetor 2025, që ndryshon Vendimin 2012/642/CFSP për masa kufizuese në lidhje me situatën në Bjellorusi dhe përfshirjen e Bjellorusisë në agresionin rus kundër Ukrainës;
 - 1.7. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2025/2637, të datës 22 dhjetor 2025, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/1484 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Rusi;
 - 1.8. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/88, të datës 9 janar 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/254 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Guatemalë;
 - 1.9. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/122, të datës 16 janar 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/385 për krijimin e masave kufizuese kundër atyre që mbështesin, lehtësojnë ose mundësojnë veprimet e dhunshme nga Hamasi dhe Xhihadi Islamik Palestinez;
 - 1.10. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/239, të datës 29 janar 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2011/72 për masa kufizuese të drejtuara kundër disa personave dhe entiteteve në lidhje me situatën në Tunizi;

- 1.11. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/254, të datës 29 janar 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2023/2135 për masa kufizuese në lidhje me aktivitetet që minojnë stabilitetin dhe tranzicionin politik të Sudanit;
- 1.12. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/263, të datës 29 janar 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2023/1532 për masa kufizuese në lidhje me mbështetjen ushtarake të Iranit për luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës dhe për grupet dhe entitetet e armatosura në Lindjen e Mesme dhe rajonin e Detit të Kuq;
- 1.13. Vendimit zbatues të Këshillit (CFSP) 2026/265, të datës 29 janar 2026, që zbaton Vendimin (CFSP) 2011/235 për masa kufizuese të drejtuara kundër disa personave dhe entiteteve në lidhje me situatën në Iran;
- 1.14. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/260, të datës 29 janar 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/2643 për masa kufizuese në lidhje me aktivitetet destabilizuese të Rusisë;
- 1.15. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/383, të datës 17 shkurt 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2011/101 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Zimbabve;
- 1.16. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/432, të datës 23 shkurt 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/1484 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Rusi;
- 1.17. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/455, të datës 26 shkurt 2026, për masa kufizuese për luftimin e terrorizmit, me shfuqizimin e neneve 2, 3 dhe 3a të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/CFSP për zbatimin e masave specifike për luftimin e terrorizmit dhe shfuqizimin e Vendimit (CFSP) 2025/1577 dhe Vendimit (CFSP) 2026/421;
- 1.18. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/438, të datës 23 shkurt 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2022/266 për masa kufizuese në përgjigje të njohjes së paligjshme, okupimit ose aneksimit nga Federata Ruse, të disa zonave të Ukrainës që nuk kontrollohen nga qeveria;
- 1.19. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/490, të datës 26 shkurt 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2014/119 për masa kufizuese të drejtuara kundër disa personave, entiteteve dhe organeve në lidhje me situatën në Ukrainë;
- 1.20. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/588, të datës 16 mars 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2019/797 për masa kufizuese kundër sulmeve kibernetike që kërcënojnë Bashkimin ose shtetet e tij anëtare;
- 1.21. Vendimit zbatues të Këshillit (CFSP) 2026/645, të datës 16 mars 2026, që zbaton Vendimin (CFSP) 2011/235 për masa kufizuese të drejtuara kundër disa personave dhe entiteteve në lidhje me situatën në Iran;
- 1.22. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/646, të datës 16 mars 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2024/2643 për masa kufizuese në lidhje me aktivitetet destabilizuese të Rusisë;
- 1.23. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/696, të datës 14 mars 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2014/145 për masa kufizuese lidhur me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
- 1.24. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/763, të datës 30 mars 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2011/173 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Bosnjë dhe Hercegovinë;
- 1.25. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/762, të datës 30 mars 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2010/413 për masa kufizuese kundër Iranit;
- 1.26. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/774, i datës 30 mars 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2010/413 për masa kufizuese kundër Iranit;
- 1.27. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/779, të datës 30 mars 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2011/235 për masa kufizuese të drejtuara kundër disa personave dhe entiteteve në lidhje me situatën në Iran;
- 1.28. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/897, të datës 21 prill 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2023/891 për masa kufizuese në lidhje me veprimet destabilizuese të Republikës së Moldavisë;
- 1.29. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/614, të datës 16 mars 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2014/145 për masa kufizuese lidhur me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
- 1.30. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/886, të datës 21 prill 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2023/2135 për masa kufizuese në lidhje me aktivitetet që minojnë stabilitetin dhe tranzicionin politik të Sudanit;

- 1.31. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/504, të datës 23 prill 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2014/145 për masa kufizuese lidhur me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës;
 - 1.32. Vendimit zbatues të Këshillit (CFSP) 2026/503, të datës 23 prill 2026, që zbaton Vendimin (CFSP) 2012/642 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Bjellorusi dhe përfshirjen e Bjellorusisë në agresionin rus kundër Ukrainës;
 - 1.33. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/512, të datës 23 prill 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2012/642 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Bjellorusi dhe përfshirjen e Bjellorusisë në agresionin rus kundër Ukrainës;
 - 1.34. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/508, të datës 23 prill 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2014/512 për masa kufizuese në lidhje me veprimet e Ruisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë;
 - 1.35. Vendimit të Këshillit (CFSP) 2026/927, të datës 27 prill 2026, që ndryshon Vendimin (CFSP) 2013/184 për masa kufizuese në lidhje me situatën në Mianmar/Birmani.
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, si dhe emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të sanksionuara përmes vendimeve dhe akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian, si dhe anekseve përkatëse të përmendura në pikën 1. konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
 3. Masat shtrënguese/kufizuese do të jenë në fuqi, deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, të plotësohen apo të ndryshohen.
 4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
 5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë